# DËSHMI ARKIVI

**A-461541**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Arrestimi i Vlora Hysenit/ Shkullaku: Shteti kontrollohet nga krimi i organizuar, nuk mund të bëhen më zgjedhje |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/arrestimi-i-vlora-hysenit-shkullaku-shteti-kontrollohet-nga-i-i-org-i105534` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 05:04:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 20:08:55 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `86ba871d096b961806c03fda00e886f0847229ed73bc629cbd34086c0fff0c7f` |
| TEKSTI | `28452d7a3953ba9c195a13ed386f2a9d300ca921886c56e47de23c7563e22a9e` |
| PAMJA | `cd0cf3a2843280ba80c6f81c2183ca0e7f345ce9960c0675f4e3bebf63da3a4e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `fe438dfde73072c37ba4306fbd4d9ec431427b0f5895379ec6d616d3b6869a12` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/fe438dfde73072c37ba4306fbd4d9ec431427b0f5895379ec6d616d3b6869a12`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# Arrestimi i Vlora Hysenit/ Shkullaku: Shteti kontrollohet nga krimi i organizuar, nuk mund të bëhen më zgjedhje

Piranjat Përditësimi i fundit 22 Shtator 2026, 22:08



Gazetari Armand Shkullaku, i ftuar në emisionin 'Çim Peka LIVE' në SYRI TV, ka komentuar ndalimin e drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni dhe masën e dhënë ndaj saj 'arrest në shtëpi'.

Shkullaku tha se rastet e bëra publike duhet të provohen nga drejtësia, por sipas tij, ato nuk duhen parë si episode të shkëputura.

Duke folur për situatën e institucioneve, Shkullaku u shpreh se, krimi i organizuar ka depërtuar në strukturat shtetërore dhe se kjo, sipas tij, e ka kaluar situatën përtej një konflikti të zakonshëm politik mes mazhorancës dhe opozitës.

Sipas tij, nëse institucionet shtetërore kontrollohen nga krimi i organizuar, atëherë zhvillimi i zgjedhjeve në këto kushte nuk mund të konsiderohet normal. 'Nuk mund të bëhen më zgjedhje në Shqipëri kur është e vërtetuar botërisht që çdo institucion kontrollohet nga krimi i organizuar', tha Shkullaku.

*'Këto që ndodhin janë ca raste sporadike që duhet t'i vërtetojë drejtësia, pastaj shiko se ne s'kemi prova, kur dalin provat atëherë do flasim e të tjerë e të tjerë.*

*Po se kjo është një fenomen i shkëputur, këtë nuk mund ta përgjithësojmë sepse fajin e ka opozita, se po të ishte një opozitë tjetër Rama s'do vidhte e të tjera.*

*Dhe përveç këtyre, Ramës i kanë shërbyer për të konsoliduar këtë pushtet mafioz, ta quaj në kuptimin e plotë të fjalës, edhe një dorë diplomatësh, ambasadorësh apo edhe shtetarësh të huaj, të cilët ata e kanë parë Shqipërinë si një plaçkë për t'u grabitur dhe këtu Edi Rama ka qenë dorëlëshuar. Ka dhënë plaçkë sa ka mundur.*

*Për ta mbyllur, sot në ditën ku ne jemi praktikisht, se kjo është bërë si shprehje që themi shteti ka rënë, po praktikisht, quhet i rënë në të gjitha.*

*Dhe këtu, për ta përfunduar elementin e fundit, e kam për opozitën. Tashti, në një vend ku nuk ka shtet, ku të gjithë institucionet po dalin me letra të kapura nga krimi i organizuar, pra dhe ata që paguhen për të mbrojtur sigurinë kombëtare dhe ata kanë sigurinë e gjyshit prioritet.*

*Opozita diskuton për mënyrën se si do hyjnë në zgjedhjet lokale, për ndarjen territoriale apo për ligje të ndryshme në parlament. Unë mendoj që e vetmja gjë që duhet bërë mbas kësaj, s'ka rëndësi se cili do të jetë reagimi i Edi Ramës, jep dorëheqjen, s'jep dorëheqjen, duhet që opozita, në sinkron me ata që janë në shesh, vëlla, nuk mund të bëhen më zgjedhje në Shqipëri kur është e vërtetuar botërisht që çdo institucion kontrollohet nga krimi i organizuar.*

*Se po të kontrollohej nga Edi Rama do u jepja të drejtë këtyre levave të Edi Ramës që thonë shiko se po të hapet opozita, po të vijnë ca fytyra të reja, një alternativë më e besueshme...*

*Po këtu nuk është Rama, këtu po e shikojmë që institucionet i kontrollon në radhë të parë krimi i organizuar.'*, u shpreh gazetari Armand Shkullaku në SYRI TV.

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 22 Shtator21:30

**Protestuesit marshojnë në Ish-Bllok me flamuj kombëtar: Arrestoni Ramën**

Protestuesit vazhdojnë marshimin e tyre në rrugët e Tiranës. Me thirrje të vazhdueshme antiqeveritare, ata kërkojnë dorë...

POLITIKE 22 Shtator21:18

**Boçi: Zgjedhja e Vlora Hysenit ka qenë e qëllimshme dhe krejtësisht personale,e pavarur nga asnjë situatë në Shqipëri**

Një skandal i përmasave tronditëse ka dalë në dritë lidhur me kapjen e institucioneve të sigurisë kombëtare dhe p&e...

POLITIKE 22 Shtator21:18

**'Rama e krijoi më herët alibinë për arrestimin e Vlora Hysenit', Bushati: Është në ngërç, mund të ketë dosje...**

Analisti Andi Bushati shprehet se kryeministri Edi Rama ishte në dijeni në arrestimit të drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni, ndaj p&eu...

POLITIKE 22 Shtator21:07

**Presidenti Begaj dekreton shkarkimin e Vlora Hysenit nga drejtimi i SHISH**

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, ka dekretuar këtë të martë shkarkimin e Vlora Hysenit nga detyra e Drejtorit të Shër...

POLITIKE 22 Shtator20:56

**SPAK caktoi "arrest shtëpie" për drejtoreshën e SHISH/ Protestuesi: Sot shteti ra, Rama të shporret**

Një protestues gjatë fjalës së tij para Kryeministrisë përmendi masën e sigurisë ndaj drejtoreshës së SHI...

POLITIKE 22 Shtator20:50

**Mbyllen fjalimet, protestuesit "skuqin" bulevardin Dëshmorët e Kombit**

Vazhdon protesta e qytetarëve kundër qeverisë në ditën e 115. Aktivistët në fjalimet e tyre thanë se kryeminstri Rama d...

POLITIKE 22 Shtator20:44

**Vlora Hyseni, shefja e SHISH nën hetim! Rastet e rralla në botë kur arrestohen dhe dënohen krerët e shërbimeve inteligjente**

Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar pezulloi sot nga detyra dhe vendosi nën masën e "arrestit sht&eu...

POLITIKE 22 Shtator20:36

**Eurodeputetja i bashkohet protestës në Tiranë: Mbroni lirinë dhe vendin tuaj**

Eurodeputetja Ana Strolenberg mbajti një fjalim në protestën e 115-të para kryeministrisë. Ajo inkurajoi protestuesit të vaz...

POLITIKE 22 Shtator19:55

**Foli në protestë, aktorja Egla Ceno zbulon SMS kërcënuese: Do të p*rdhunoj në mes të Tiranës**

Një ditë pasi foli në protestën kundër qeverisë, aktorja Egla Ceno thotë se ka marrë një mesazh kërcënues...

POLITIKE 22 Shtator19:56

**"Shteti ka rënë, Rama duhet të ishte dorëhequr tashmë", aktivisti: Ky vend drejtohet nga mafia dhe krimi, duhet ndryshim**

Këtë të martë mbahet protesta e 115-të para kryeministrisë, ku synohet largimi i qeverisë Rama. Pas zhvillimeve të fundi...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 22 Shtator

**Shkuan për t'i blerë dhuratën të ëmës për ditël...**

Tri motra humbën jetën pasi një zjarr përfshiu një qendër tregtare, duke detyruar klientët e tmerruar të hidheshin nga d...

AKTUALITET 22 Shtator

**Aksioni i SPAK/ Kontrolle dhe në bazat e Tropli...**

Të tjera detaje kanë dalë në dritë nga operacioni i SPAK, i ndërmarrë paraditen e kësaj të marte. Raportohet se ...

AKTUALITET 22 Shtator

**A është cenuar siguria kombëtare? SPAK lëshoi "...**

SPAK lëshoi sot masën e sigurisë 'arrest shtëpie' për kreun e SHISH, Vlora Hyseni, e cila po hetohet për skandalin e...

INVESTIGIME 19 Shtator14:14

[Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës]

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

## video



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**




**“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit**



**Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.